




www.fqurani.com

KËSHILLA

Përmbajtja/ Mars 2011 (Nr. 40)

Do të lexoni:

-  **Shkolla e humanizmit** **4**
-  **Gjuha jonë, sa e mirë!** **22**
-  **Një jobesimtar beson Zotin** **24**
-  **Vepra të dobishme për mbrojtjen nga egërsia e varrit** **27**
-  **Fjalë të urta** **38**

e të tjera...

KËSHILLA

Nr. 40, Mars, 2011
Organ i Fondacionit të Kur'anit

Drejtor:
Prof. Muhammed Reza
HAXH KHEZR

Kryeredaktore:
Liseda RAMAJ

Drejtor artistik:
Vullnet MERJA

Korrektori:
Vjollca FEZA

Design & Layout:
Aurora SHEHU

Bashkëpunuan:
Vullnet MERJA,
Vjollca FEZA,
Sabrie FEZA,
Selim STAFJA,
Majlinda NDRECA,
Jelmir CELA etj.

Përgjegjëse për rubrikën
"Selam": Mina Mekami
Bashkëpunëtorë:
Rejhane Ikbali,
Fatime Haxh Khezer,
Mina Mekami,
Sabrie Feza



Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) solli për njerëzit shembullin më të mirë të asaj çka mëson feja islame. Personaliteti i njeriut krijon një kompleks më vete për sa i takon fuqisë së përkushtimit. Faktorët e jashtëm shoqërorë ndikojnë në sjellje e perceptim. Sa herë që ndodhin të tilla situata njeriu është i lëkundur e besimi i tij mund të cënohet. Atëherë, siguria e tij e vetme dhe më e fortë është rikthimi tek vlerat e morali që na ka lënë vetë i Dërguari i Zotit, Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe mësimet kur'anore. Mirësia njerëzore aty e ka burimin. Në këtë muaj që po afron të gjithë myslimanët presin Ditëlindjen e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Le të jenë ata ndjekësit e shembullit të tij e Zoti ua ndriçoftë zemrat në rrugën e fesë islame!

Kryeredaktorja

Adresa: Rr. Hoxha Tahsim Nr. 168
Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 04 -2 377 311
Tirana – Albania
WebSite: www.fqurani.com
E-mail: f_quran114@yahoo.com

Mesazhi i Profetit është **global**

(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

Profeti ynë i dashur, Muhamedi i biri i Abdullahut, është simboli i të gjitha të mirave, material dhe shpirtërore për mbarë botën. Ai është simbol i humanizmit në ndërgjegjen e kulturës botërore e cila që herët ka studiuar idetë dhe jetëshkrimin e profetit si udhëheqës, mësues dhe udhërrëfyes.

Askush nuk mbart personalitet më të lartë se ai i burrit më të madh në këtë jetë, profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!). Në të gjitha kohët nuk është dukur si ky personalitet i lartë, i cili bëri ndryshime rrënjësore e të gjëra në historinë e njerëzimit. Ky qytetërim që solli Profeti vazhdon të ushqejë mbarë botën me njohje dhe dije për shekuj të tërë.

Doktor Maikell Hart, profesor i matematikës, astronomisë dhe fizikës në Universitetin amerikan si dhe specialist në grupin kozmik amerikan thotë: "e zgjodha Muhamedin të parin në listë dhe shumë njerëz kanë të drejtë të çuditen me këtë zgjedhje. Mirëpo Muhamedi është njeriu i vetëm në histori i cili korri sukses të plotë qoftë nga ana fetare po ashtu edhe jetësore. Ai ftoi në Islam dhe e përhapí atë si një ndër fetë më madhështore. Ai ishte udhëheqës politik, ushtarak dhe fetar. Pas kalimit 13 shekujve nga vdekja e tij, gjurmët dhe ndikimet e Muhamedit vazhdojnë të jenë të forta dhe ringjallëse.

Madhështia e profetit Muhamed duket shumë qartë nëpërmjet ndryshimit të madh që bëri në gadishullin arabik duke e nxjerrë atë nga skëterrta e injorancës dhe zakonet pagane në dritën e monoteizmit. Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:


“All’Ilahu e dërgoi atë (profetin Muhamed) kur njerëzit ishin në humbje e në çoroditje. Të zhytur në përçarje e shkatërrim. Ata ishin të magjepsur me egon dhe lakminë...”

Profeti porositi shumë dhe ndoqi rrugën duke i ftuar në urtësi e këshillë të mirë.”
All’Ilahu i Madhëruar në Kur’an thotë:



“Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju, i Atij që i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Nuk ka zot tjetër të vërtetë veç Atij; Ai jep jetë dhe vdekje, prandaj besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e lexim e që beson në Allahun dhe Fjalët e Tij! Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!”

Në fjalinë e ajetit të parë: “Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju” gjendet thirrje për të gjithë njerëzit të çdo kohe dhe vendi, të çdo kombi e kombësie, pa dallim race e ngjyre. Për ata që ishin të pranishëm në kohën e zbritjes së ajetit dhe për ata që janë dhe do të vijnë. Prandaj, ky është urdhër i All’Ilahut të Madhëruar, Krijuesi i gjithçkaje, që të gjithë njerëzit ta ndjekin profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e All’Ilahut qofshin mbi të dhe mbi



familjen e tij!) sepse Ai e dërgoi atë për mbarë njerëzit.

“I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët.”

Në këtë ajet All’Ilahu i Madhëruar e ka cilësuar profetin Muhamed “rob të Tij”. Në të vërtetë ky është “medalion nderi” për Profetin sepse, ai është rob i All’Ilahut dhe jo rob i vetes së tij. Ai ka qenë sundues dhe kontrollues i vetes së vet. Ai, që me të vërtetë është rob i All’Ilahut, ai është sundues dhe kontrollues i vetes së vet. I tillë ishte profeti Muhamed dhe për këtë iu shpall Dalluesi (Kur’ani) dhe për këtë është edhe paralajmërues për të gjitha botët.

Përgatiti: H. Vullnet Merja

Drejtimi I FAMILJES

Mjedisi familjar ka po aq nevojë për dashurinë njerëzore të gruas dhe ndjenjave të saj shpirtërore, sa ka nevojë për fuqinë, vendosmërinë, planin, kontrollin dhe drejtimin e burrit. Duke pasur parasysh se këto cilësi janë më të theksuara në karakterin e burrit, Islami i ka dhënë këtij të fundit të drejtën e drejtimit të familjes.

Kuptohet se edhe familja, si çdo organizatë, bashkësi, etj., në shoqëri ka nevojë për një drejtues. Në qoftë se burri nuk arrin të marrë përsipër këtë drejtim ose e drejton keq, atëherë kemi të bëjmë me prishjen e rregullit dhe rendit të përgjithshëm brenda familjes. Këtu duhen pasur parasysh dy pika:

1- Burri duhet të vendosë drejtimin e familjes në krye të programit të tij dhe të mos e anashkalojë apo ta nënvleftësojë atë. Disa burra mendojnë se detyra e tyre e vetme është sigurimi i të ardhurave familjare edhe me kaq mbyllet dhe dosja e detyrave të tyre familjare. Pra, duket qartë se të tillë burra nuk janë të informuar aq sa duhet për detyrat familjare, duke u bërë bisht pjesës më të madhe të detyrimeve të tyre. Në këtë mënyrë, nuk janë gjë tjetër veçse të huaj në shtëpinë e tyre. Pa dyshim, që këta



Disa burra mendojnë se detyra e tyre e vetme është sigurimi i të ardhurave familjare edhe me kaq mbyllet dhe dosja e detyrave të tyre familjare. Pra, duket qartë se të tillë burra nuk janë të informuar aq sa duhet për detyrat familjare, duke u bërë bisht pjesës më të madhe të detyrimeve të tyre. Në këtë mënyrë, nuk janë gjë tjetër veçse të huaj në shtëpinë e tyre.

tipa burrash nuk veprojnë siç duhet me drejtimin e familjeve. Prandaj theksojmë edhe një herë se familja aq sa ka nevojë për gruan, po aq ka nevojë edhe për burrin dhe asnjëri prej tyre nuk e zëvendëson dot tjetrin.

2- Nuk duhet ngatërruar drejtimi i familjes me ligjin e më të fortit, pra, dhunën. Kjo gjë, jo vetëm që nuk ka kuptimin e drejtimit, por e kufizon dhe e pengon familjen nga lumturia e vërtetë e saj duke futur grindje dhe mosmarrëveshje midis çiftit. Në këtë kontekst, edhe pikëpamja qiellore e përball njeriun me rezultate dhe përfundime të rënda.

Thuhet se kur vdiq një nga bashkëkohësit e profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), vetë Profeti mori pjesë në ceremoninë mortore të tij. Nëna e të ndjerit, kur pa Profetin midis të tjerëve,

iu drejtua djalit të saj të vdekur me këto lutje: *“Lum ti që shkove në Xhenet!”*. Ndërsa Profeti u shpreh: *“Qetësohuni dhe mos flisni me bindje të plotë në punën e Zotit, sepse djali juaj tashmë është në vuajtje dhe nën presion të plotë.”* Të pranishmit u befasuan nga këto fjalë dhe e pyetën Profetin për arsyen. Profeti u përgjigj: *“Ai sillej keq me familjen e tij.”*

Kur’ani i fton të gjithë burrat që të jenë të sjellshëm, gjakftohtë në familjet e tyre dhe gjithashtu, u ka dhënë urdhër që të jenë të sjellshëm me bashkëshortet e tyre:

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për këtë është shprehur:

“Më i miri nga ju është ai që është më i mirë për familjen e tij dhe unë jam më i mirë se ju për familjen time. Njerëzit që e vlerësojnë gruan do të nderohen dhe ata që e poshtërojnë atë, do të poshtërohen përfundimisht.”

“Në qoftë se gruaja ose burri e keqtrajton bashkëshortin e vet, Zoti atij nuk ia pranon namazin dhe asnjë veprim tjetër të mirë të tij, derisa t’i kthejë gëzimin bashkëshortit.”

Burri duhet të këshillohet me bashkëshorten e vet, sidomos për problemet që kanë të bëjnë me të. Nga ana tjetër, gruaja duhet të pranojë udhëheqjen e burrit dhe me bindje dhe me mundësitë e saj duhet ta ndihmojë bashkëshortin për ta drejtuar më mirë familjen. Por sidoqoftë, duhet të ketë parasysh se asnjë lloj shoqërie, organizate, bashkësie a grupimi, ku edhe familja nuk bën përjashtim nga këto, nuk drejtohet dot

pa një drejtor ose përgjegjës që të tjerët ta dëgjojnë dhe t’i binden fjalëve të tij. Familjet, ku roli i përgjegjësisë së burrit është i dobët, përballen me probleme të shumta. Në këtë kontekst, Islami rregullat e tij i mbështet mbi bazën e karakterit dhe krijimit të njeriut. Në sistemin familjar drejtimin e familjes ia ka besuar burrit, ku të tjerët, me bindje dhe me bashkëpunimin e tyre, ndihmojnë në këtë drejtim.

Në këtë mënyrë është bërë shpërndarja e detyrave dhe e të drejtave, me qëllim që drejtimi i familjes të jetë më i përkryer dhe asnjë prej tyre të mos ketë përparësi te tjetri.



Bashkëpunimi në familje

Nuk ka dyshim që mirëkuptimi dhe bashkëpunimi është themeli i bashkëjetesës familjare. Bashkëpunimi mund të jetë në forma të ndryshme, sipas gjendjes së familjes. Në disa familje gruaja nuk ka aktivitete jashtë shtëpisë dhe në këtë mënyrë përpiqet që të jetë pjesëmarrëseja dhe partnerja kryesore në punët brenda shtëpisë, duke i krijuar mundësi më të mëdha burrit në aktivitete jashtë shtëpisë,

për të siguruar të ardhurat e familjes. Ndërsa në disa familje të tjera, ku gratë zotërojnë profesione të ndryshme dhe kanë aktivitete jashtë shtëpisë, u ngelet më pak kohë për problemet brenda shtëpisë. Në këto raste është e domosdoshme ndihma e burrit që të plotësohet ky boshllëk i krijuar në familje. Pra, mund të ndodhë që në një familje, për arsye të kushteve ekonomike të veçanta, burrit i duhet të shpenzojë me tepër kohë në aktivitetet e tij jashtë shtëpisë për të siguruar ekonominë e familjes dhe është e natyrshme që t'i mbetet pak kohë për problemet e brendshme të familjes, por me sakrificat e bashkëshortes, në këtë pikë, ky boshllëk mund të plotësohet më së miri. Sidoqoftë, në rregullat islame, aktiviteti i burrit ose i gruas në problemet e brendshme familjare ka vlera të mëdha shpirtërore dhe si i tillë do të shpërblehet.

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Në qoftë se gruaja brenda shtëpisë do të punojë si burrë, atëherë Zoti do të vendosë mirësinë e Tij mbi të dhe në qoftë se Zoti vendos mirësinë e Tij mbi dikë, do të thotë që ky njeri është i sigurt nga torturat e Xhehenemit.”*

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), aktivitetin e burrit brenda familjes e paraqet si falje të gjynaheve të mëdha të tij. Nga këto fjalë kuptojmë se sistemi familjar duhet të bazohet në sakrificat dhe shërbimet reciproke, ku këto të fundit janë funksionin i singjeritetit dhe i dashurisë për njëri-tjetrin. Jeta e profetëve dhe e imamëve është një shembull i përkryer i këtij problemi, sepse ata, përveç punëve dhe aktiviteteve të rënda shoqërore jashtë familjeve të tyre, gjenin kohë edhe për problemet e brendshme në familjet e tyre.

Një pikë me rëndësi të madhe për këtë problem është falënderimi i partnerëve ndaj njëri-tjetrit, për sakrificat dhe shërbimet që janë kryer. Mosvlerësimi dhe mosfalënderimi nga tjetri konsiderohet si sjellje e shëmtuar që shkakton lindjen e urrejtjes.



Roli i edukimit të njëri-tjetrit tek çifti

Gruaja dhe burri janë të pajisur me veçori të ndryshme fizike dhe psikologjike, për arsye të forcimit të lidhjes së tyre dhe ndarjes më të përshtatshme të detyrave dhe të të drejtave. Në këtë kontekst, burrin dhe gruan mund t'i përkufizojmë si plotësues të njëri-tjetrit, ku në plotësimin e tyre kanë nevojë për njëri-tjetrin.

Duke qenë në një rrjedhë singjeriteti në familje, secili mund të përfitojë nga virtytet dhe investimet shpirtërore të tjetrit dhe t'i vendosë ato në shërbim të përsosurisë së vet. Dashuria e brendshme te gruaja dhe ndjenjat e saj të zhvilluara në këtë dimension mund të jenë faktorë për pastrimin e shpirtit të burrit dhe përf forcimin e dimensionit të dashurisë në karakterin e tij dhe anasjelltas grujamundtëndikohet nga qëndrueshmëria shpirtërore e burrit dhe forca e tij logjike që të stabilizojë lëkundjet e veta shpirtërore dhe të modifikojë karakterin e saj në favor



të qëndrueshmërisë së personalitetit të saj, i cili është i paqëndrueshëm në saje të ndjenjave të forta të dashurisë që ekzistojnë tek ajo.

Në familjet që kanë themele të shëndosha dhe që drejtohen mbi bazën e boshtit të së vërtetës dhe të virtutit, burri dhe gruaja janë faktorë të përsosurisë dhe të lumturisë së njëri-tjetrit. Në këto familje, bashkëpunimi i singertë duket qartë jo vetëm në problemet e brendshme, por në të gjitha çështjet, ku secili lumturinë e tij e kërkon te tjetri.

Kushti më i rëndësishëm për vazhdimin e sinqeritetit

Kushti më i rëndësishëm i familjes, që e dallon atë nga shoqëria civile, është se në familje qeveris dashuria dhe sinqeriteti. Pra, në qoftë se në shoqërinë civile qeverisin dhe mbretërojnë ligjet, në familje, ato do të ishin: dashuria për njëri-tjetrin, sinqeriteti dhe falja njerëzore.

Është e nevojshme të rikujtohet se lidhjet njerëzore janë të ndërtuara mbi bazën e vetive të veçanta, ku pakujdesia më e vogël mund të krijojë dëme të mëdha. Pra, me fjalë të tjera, krijimi i sinqeritetit në një lidhje shpirtërore nuk është gjë e lehtë, por vazhdimësia dhe mbajtja gjallë e kësaj lidhjeje është akoma dhe më e vështirë dhe kërkon kujdes më të madh.

Ato që shkaktojnë shkatërrimin e lidhjes dhe i largojnë zemrat nga njëra-tjetra, pa dyshim që janë problemet që lindin si rezultat i preferencave dhe shijeve të ndryshme ose i pakujdesive dhe i pavëmendjes. Njerëzit që janë në dijeni për vlerat e sinqeritetit nuk janë kurrë të gatshëm që për arsye boshe dhe të pavlera ta shkatërrojnë këtë virtut, por gjithmonë përpiqen që, duke falur, të shmangin rrezikun e zhdukjes së sinqeritetit dhe bashkë me të edhe të lidhjes shpirtërore.

Diçka që duhet pasur parasysh këtu është se asnjëherë dy njerëz nuk janë të ngjashëm në të gjitha drejtimet dhe si rezultat, do të kemi ndryshim në preferencat dhe shijet e tyre, të shoqëruar edhe me mendime dhe pikëpamje të ndryshme. Përveç kësaj, askush nuk është njeri i pastër fare nga gjynahet. Të gjithë jemi të gabueshëm dhe duhet të mendojmë se si t'i eliminojmë gjynahet. Prandaj mendimi se ekziston ndonjë njeri i ngjashëm me ne në të gjitha drejtimet është praktikisht i gabuar. Pra, duhet që në lidhjet njerëzore dhe ato familjare në veçanti, me anë të faljeve dhe të kompromisit, të përpiqemi t'i forcojmë dhe asnjëherë të mos krijojmë ftohje për arsye të mendimeve jo të logjikshme, kokëfortësisë, kapriçoze dhe të tjera të ngjashme me këto. Mjedisi familjar është një mjedis i shenjtë, ku secili, burri dhe gruaja duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe veten në eliminim e problemeve të ndryshme që mund të kenë. Rruga më e mirë në këtë drejtim për të dy është falja e gabimeve të tjetrit, duke e ndihmuar atë në ndreqjen e tyre.

Së fundi, në mënyrë që lidhja shpirtërore të thellohet dalëngadalë duhet të krijohet lumturia dhe gëzimi i tjetrit.

Ah, koka!
Ah, koka!

Tregim

Një njeri që nuk kuptonte arsyen pse ishte haram alkooli vajti tek një njeri i mençur dhe e pyeti: - A më bën dëm të ha pak rrush? – Jo, nuk të bën dëm.

-Po sikur të ha pak bar pas rrushit? - Nuk të ndodh asgjë, mund të hash.

-Po sikur të pi edhe pak ujë, a më bën dëm? – Jo, nuk të bën dëm.


Burri mbeti shumë i kënaqur nga këto përgjigje dhe tha: -Po sikur t'i përziej këto të trija, a bëhen një verë shumë e mirë?!

Po t'i përziej në stomak nuk është haram, atëherë përse bëhet haram po t'i përziej përpara se t'i fus në stomak? Njeriu i mençur buzëqeshi, mori një grusht dhë edhe e pyeti burrin: -Po të ta hedh këtë dheun, a vritesh? – Jo. Po të hedh edhe pak ujë a vritesh? – Jo. -Po të të lë të presësh 5 minuta në diell a ndien dhembje? – Jo. Njeriu i mençur vazhdoi: -Po t'i bashkoj dheun, ujin dhe nxehtësinë e diellit dhe më pas të të godas në kokë, çfarë ndodh?

Burri, kur dëgjoi këto fjalë, vuri duart në kokë dhe filloi të bërtiste: -Ah, koka! Ah, koka!

-Nuk po të gjuan askush me tullë në kokë, tani çfarë ke që bërtet?

-Nuk po më gjuan me tullë, por fjalët që the më ranë në kokë më të rënda se tullat.



Gjuha jonë, sa e mirë!

Shqipja është një ndër gjuhët e lashta të Ballkanit e të Europës. Ajo bën pjesë në familjen e gjuhëve indoeuropiane. Familja e gjuhëve indoeuropiane përfshin gjuhë që kanë burim të përbashkët e afri njëra me tjetrën dhe që janë folur që në kohët parahistorike në vendet që nga India e deri në Europë. Po ta paraqitim në trajtë peme këtë familje, do të kishim një dru me 12 degë. Degët e drurit kanë edhe degëzime, pra, kanë gjuhë të tjera më të afërta me njëra-tjetrën; p.sh., dega sllave ka disa degëzime: rusishtja, ukrainishtja, bjellorusishtja, polonishtja, bullgarishtja, çekishtja, sllovakishtja, serbishtja etj. Dega shqipe nuk ka asnjë degëzim.

Pra, shqipja është gjuhë indoeuropiane. Cilat janë simotrat e saj? Simotrat e saj janë: anglishtja, gjermanishtja, holandishtja, danishtja, suedishtja, norvegjishtja, islandishtja, irlandishtja, italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, portugalishtja, rumanishtja, moldavishtja, lituanishtja, letonishtja, rusishtja, ukrainishtja, bjellorusishtja, polonishtja, çekishtja, sllovakishtja, sllovenishtja, serbishtja, kroatishtja, bullgarishtja, maqedonishtja, greqishtja, armenishtja, persishtja (flitet në Iran etj.), indishtja, urdishtja (në Pakistan), ciganishtja etj. Hungarishtja, finlandishtja, estonishtja e turqishtja nuk janë gjuhë indoeuropiane; i përkasin një familjeje tjetër. Disa nga gjuhët e hershme indoeuropiane janë zhdukur dhe quhen gjuhë të vdekura, kurse nga disa gjuhë të tjera të hershme indoeuropiane janë zhvilluar gjuhë të mëvonshme; ato kanë qenë, si të thuash, “nëna”, nga të cilat kanë ardhur “bijat”;



p.sh., nga latinishtja kanë dalë italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, rumanishtja etj. Nga ilirishtja – gjuha e ilirëve është zhvilluar gjuha shqipe.

Në shkollat e mëtejme dhe sidomos, në universitet, në degën e gjuhësisë do të mësoni edhe pse gjuhët që u përmendën më lart janë të një familjeje, pse janë të afërta, pse janë simotra. Tani mund t'ju themi që kanë të afërta fjalë që shënojnë numërorë (1-10), përemra vetorë, farefisni, dukuri të motit etj. Krahaso, p.sh., për nënë: në anglishte *mother*, në ruseshte *mat*, në gjermanishte *Mutter*, në lituanishte *mate*, në greqishten e vjetër *mater*, në persishten e vjetër *bamatar*, në sanskritishte (gjuhë e vjetër në Indi) *matar* dhe në shqipe *motër*. Në shqipe ka ndryshuar shqiptimin *a* → *o* dhe kuptimin; dikur edhe kjo kishte kuptimin *nënë* si në gjuhët simotra. Shih fjalët: *dimër*: në ruseshte *zima*, në sanskritishte *hima* (kujtoni emrin e malit Himalaja), në latinishte *hiems* etj.; *ujk* (trajtë më e hershme *ulk*): në anglishte *wolf*, në gjermanishte *Wolf*, në greqishten e vjetër *lykos* etj.; *ditë*: në anglishte *day*, në ruseshte *djen*; *natë*: në anglishte *night*, në ruseshte *noç*, në gjermanishte *Nacht*, në lituanishte *naktis*, në greqishten e vjetër *nyks*, në sanskritishte

nakti (sigurisht me ca ndryshime nga ana gjuhësore, por që nuk ua humbasin afrinë). Kur të shkoni në universitet ose duke lexuar e studiuar vetë do të mësoni edhe shumë gjëra të tjera për gjuhët indoeuropiane e vendin e shqipes në këtë familje; do të mësoni për gjuhëtarët shqiptarë dhe të huaj që janë marrë e merren me studimin e historisë së gjuhës shqipe, si Aleksandër Xhuvani, Eqerem Qabej, Mahir Domi, Dhimitër Kamarda, Norbert Jokli, Franz Boppi, Shaban Demiraj, Idriz Ajeti, Besim



Bokshi e shumë të tjerë.

Ku është formuar gjuha shqipe dhe kur është formuar ajo – edhe këtë do ta mësoni më vonë, kur të bëheni student a studente. Por nga ka ardhur gjuha shqipe? Dijetarët kanë vërtetuar, siç u përmend më lart, se ajo vjen nga ilirishtja, se është zhvilluar ca nga ca nga ilirishtja, në brigjet lindore të detit Adriatik dhe të detit Jon, midis shekujve IV-V të erës sonë. Shqiptarët janë pasardhësit e ilirëve; pra, edhe gjuha shqipe është “bija” e ilirishtes. Kur të bëheni student a studente do të mësoni edhe nga erdhi emri **shqiptar** dhe **Shqipëri** etj.

Si është vërtetuar se gjuha shqipe vjen nga ilirishtja?

Nga emrat e vendeve. Emrat e vendeve japin mundësi për të dëshmuar vijimësinë iliro-shqiptare. Dijetarët kanë provuar se sipas ligjeve të gjuhës shqipe, *Dardani* (Kosova e sotme) lidhet me fjalën *dardhë* (vend ku rriten dardhë). *Dalmatia* (Dalmacia, krahinë në

Kroaci) është krahasuar me shqipen *delme/dele*. Ulqini (trajta e hershme *Ulcinium*) është lidhur me *ulk* (ujk). *Dimalum* – qytet

ilir, është lidhur me *di* (dy) male etj. Edhe *Karpate* (male në Rumani) i kanë afruar me shqipen *karpë* (shkrep, kep). Habitëni? Mos u habitni. Sepse, siç dihet, rreth 2000 vjet para erës sonë, ilirët kanë zbritur nga Pellgu i Danubit në Brigjet e Atlantikut. Gjurmë të ilirishtes vijnë edhe nga emrat e njerëzve. Kështu *Bardylis* është krahasuar me shqipen *Bardhyl*, *Daisus* me *Dash* etj. Edhe disa fjalë në latinisht e në greqishten e vjetër shpjegohen vetëm me anë të gjuhës shqipe. Kështu, p.sh. *brisa* e latinishtes është shpjeguar me *bërsi* të shqipes “mbeturinat e kokrrave të disa pemëve e bimëve pasi shtypen e shtrydhen për të nxjerrë vajin, lëngun etj.”), *laros* e greqishtes së vjetër (pulëbardhë) është lidhur me shqipen *larë* e *rhinos* është lidhur me *re* të shqipes; etj.

Përgatiti: Prof. Hajri Shehu



Z

RRËFIME

Rrëfimi i parë

Fudejl bin Ajjad, një nga mësuesit e besimit islam, në mesin e nxënësve të tij kishte një nga më të pregatiturit.

Një ditë, nxënësi i mirë u sëmur aq rëndë sa që vdekja iu afrua.

Fudejl bin Ajjadi shkoi ta vizitonte nxënësin. Ai u ul tek koka e tij dhe filloi të lexonte suren "Ja Sin" Nxënësi, që ishte në shtratin e vdekjes, i tha: "Mos e lexo këtë sure!"


Mësuesi e ndaloi leximin e sures dhe i tha nxënësit: "*Thuaj: S'ka Zot tjetër përveç Allahut*". Nxënësi iu përgjigj: "Nuk e them këtë shprehje se e urrej." dhe vdiq në këtë gjendje.

I çuditur nga kjo gjë, Fudejli shkoi në shtëpi dhe qëndroi pa dalur fare. Natën ai pa në ëndërr nxënësin e tij duke e hedhur në zjarrin e Xhehenemit.

Fudejl bin Ajjadi i tha: "Ishe nxënësi më i mirë nga nxënësit e mi, çfarë ndodhi me ty që Allahu të zhveshi nga njohuritë e tua dhe të dha një fund me një dënim kaq të vështirë?"

Ai u përgjigj: "Shkak për këtë janë bërë tri gjëra: Kam qenë thashethemexhi, kam qenë ziliqar, kam pirë alkool për shkak të sëmundjes që kisha. Doktor i më këshilloi që të pija një gotë alkool në vit, duke më thënë se nëse nuk e pija këtë nuk kishte shërim për sëmundjen time."

Këto tri gjëra janë bërë shkak i vuajtjeve të mia.



Rrëfimi i dytë

Shejhul Behai, në librin e tij "El Kushkul" thotë: "Në momentet e fundit të jetës së një mëkatari, shkuan te ai disa njerëz. Sa herë që i thuhej të shqiptonte se s'ka Zot tjetër përveç Allahut, ai thoshte këto dy vargje të një poezie: "O Zoti im, një ditë pyeta dhe isha e lodhur: Nga është rruga e hamamit të njohur?"

Shkak i kësaj gjëje ishte se një grua e pasur dhe e bukur donte të shkonte një ditë në hamamin e njohur "munxhab", por ajo nuk e njihte rrugën dhe duke kërkuar u lodh nga të ecurit. Kur pa një burrë (atë që thoshte dy vargjet e poezisë), e pyeti për hamamin. Ai i tha: "Ja ku është, duke i bërë shenjë për tek dera e shtëpisë së tij." Në momentin që ajo hyri në shtëpi, burri mbylli derën. Kur gruaja e ndjeu rrezikun nga burri, filloi të ekspozonte pjesët e bukura të trupit të saj dhe i tha: "Bli diçka të mirë për të ngrënë dhe kthehu sa më shpejt." Burri, duke i besuar asaj dhe dëshirës së saj,

doli për të blerë dhe kështu gruaja shpëtoi nga rreziku."

Kjo vepër e ndalonte të sëmurin në shtratin e vdekjes që të përmendte dëshminë (shehadetin) në momentet e fundit të jetës së tij, edhe pse ai nuk arriti të bënte imoralitet me atë grua.

Vepra të dobishme për mbrojtjen nga vështresia e varrit

1 - Transmetohet se Imam Bakiri ka thënë: **"Ai që plotëson rukunë e tij, nuk do të përballet me vetminë e varrit."**

2 - Gjithashtu, kush thotë njëqind herë në ditë **"La ilahe il-la Allahu El Melikul Hakkul Mubin"** (S'ka Zot tjetër përveç Allahut, Zotëruesit të së Vërtetës së qartë), kjo thënie do të jetë mbrojtje nga vuajtjet dhe egërsirat e varrit, do të trajtohet si i pasur dhe do t'i hapen dyert e Xhenetit sikurse ka ardhur edhe në hadith.

3 - Leximi i sures "Ja Sin" para gjumit.

4 - Falja e namazit natën e Regaibit.

5 - Transmetohet, gjithashtu: "Ai që agjëron njëzet e dy ditë nga muaji Sha'ban, në varr do të vizitohet nga shtatëdhjetë mijë melekë çdo ditë deri sa t'i fryhet Surit."

6 - Atij personi që viziton një të sëmure, Allahu i Madhëruar do t'i ngarkojë një melek që do ta vizitojë në varrin e tij deri në Ditën e Ringjalljes.

Marrë nga "Vendqëndrimet e Botës Tjetër"

Emrat e bukur të Zotit

El Mutekebbir – I Madhërishmi

***“Ai është Allahu që nuk ka zot
tjetër përveç Tij, Sunduesit,
të Shenjtit, Paqedhënësit,
Siguruesit, Mbizotëruesit,
të Gjithëmëshirshmit, të
Madhërishmit.” (59:23)***

Allahu ka gjithë krenarinë dhe lavdinë. Ai është pa nevoja dhe është pa të meta. Ai është përtej cilësive të asaj çka krijuar.

“Vetëm e Tij është Lavdia dhe Madhështia në qiej dhe në tokë.” (45:37)

Krenaria, një atribut hyjnor, kurrë nuk duhet të pretendohet nga njerëzit. Allahu urren njerëzit krenarë që lartësohen karshi të tjerëve. ***“Allahu nuk e do asnjë arrogant që u lavdërohet të tjerëve.”*** (57:23) ***“Krenaria dhe lavdia janë rroba të Mia, kushdo që i pretendon do ta torturoj.”*** (Muslimi)

Dënimi në këtë botë është verbëria shpirtërore. ***“Unë do t’i privoj nga ajetet e Mia ata të cilët do të sillen me kryelartësi e me kundërshti në tokë, por edhe sikur ata t’i shohin të gjitha ajetet (provat, treguesit,***

shpalljet), ata prapë nuk do t'i besojnë.” (7:146). I Dërguari (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të!), ka thënë: **“Ai që ka në zemrën e tij mendjemadhësi sa pesha e një grimce nuk do të hyjë në Xhenet.”** Një njeri, pyeti pastaj: “Ç’ka nëse ndonjëri pëlqen të vishet bukur?” I Dërguari (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të! u përgjigj: **“Me të vërtetë, Allahu është i Bukur dhe e do të bukurën. Mendjemadhësia është të mohosh të vërtetën dhe t’i përbuzësh njerëzit.”** (Muslimi)

Megjithatë, për robtë e mirë të Tij Allahu është i Mirë dhe i Dashur: ***“Kushdo që vjen te Unë duke ecur, Unë i afrohem atij duke vrapuar.”*** (Buhariu)

Mbaje Zotin në zemrën tënde, sepse kjo është gjendja më e mirë.



SHKOLLA E HUMANIZMIT

Njeriu, qenia e vetme në botë që gjurmon dhe hulumton, njëkohësisht është lëndë e këtij studimi.

Termi *humanizëm* (njerëzshmëri) gjithnjë është përkufizuar si diçka e shenjtë dhe fisnike. Humanizmi në shekujt e fundit, krahas zhvillimit të madh të shkencës, e ka humbur pozitën e shenjtë e të bekuar që kishte te gjeneratat e mëhershme.

Zbulimet e para të njeriut kishin të bënin me astronominë, sepse përnjëherë u ndryshua ajo që njeriu më parë mendonte për Tokën se ajo gjendej në qendër të botës dhe se yjet dhe planetet e tjera silleshin rreth saj. Më pas, njeriu e kuptoi se Toka ishte një planet i vogël që rrotullohej rreth diellit. Atëherë, u mohua pohimi se njeriu ishte qendra e mundësive dhe qëllim i krijimit, dhe askush më nuk mori guximin të fliste për të. Njerëzit thonin: "Jo, nuk është njeriu ashtu siç e kemi paramenduar". Me këtë grusht shkencor ai e humbi atë bindje të tij të vjetër se ishte qendra e botës, ndërkaj kjo ide shkonte krahas bindjes se Toka ishte qendra e yjeve dhe e

galaktikës. Pastaj njeriu mori edhe grushta të tjerë të mëdhenj, siç ishte ai që njeriu e konsideroi veten si qenie qiellore, si mëkëmbës dhe shpirt i Zotit, e që është krijuar duke u frymëzuar nga Shpirti hyjnor.

Studimet biologjike nga lëmi i evolucionit, menjëherë gjenezën e njeriut e lidhën me shtazët, kështu që njeriu u nënçmua. Në studime të tilla thuhej: "O njeri! Ti i takon racës së majmunit, madje edhe sikur të paramendonim që nuk i takon racës



së majmunit, gjithësesi ke prejardhje shtazarake dhe i takon llojit të shtazëve.

Që nga mesi i shekullit XIX e gjer më sot përsëri paraqitet humanizmi, sërish e merr origjinalitetin e tij, përsëri paraqiten shkollat humaniste ideologjike, madje edhe në formën e njeriut hyjnor. Njeriu, në të kaluarën nuk ka qenë simbol i adhurimit, ai ishte një sinjal i madh dhe dritare e madhe kah shpirtërorja. Nuk ka dyshim se edhe sipas Kur'anit njeriu është argumenti më i qëlluar për shpirtëroren, njohjen e Allahut dhe metafizikën.

“Ne do t’u tregojmë argumentet Tona në horizont si dhe në vetë ata”. (41:53).


“Argumentet në tokë janë për të bindurit, si dhe në vetë ju. A nuk e shihni?!” (51: 20-21)

Bota është e hapur ndaj shkollës së humanizmit. Janë paraqitur disa filozofi të quajtura filozofi omanistike dhe mbase është më shumë për t’u habitur se në botë është paraqitur një fe e cila quhet “feja e omanizmit” të cilën e shpiku dhe e themeloi August Konti nga mesi i shekullit XIX. Ky njeri u gjend në një qorsokak të çuditshëm në mes logjikës e të kuptuarit në një anë dhe vetëdijes, në anën tjetër. Kështu shpiku diçka siç është “feja e omanizmit”. Ai thotë: “Feja është e patjetërsueshme për njeriun, e të gjitha veprat e liga që vërehen në shoqëri, paraqiten si rezultat i dobësimit të fesë në shoqëri. Konti përcakton tri periudha: periudhën metafizike dhe hyjnore, periudhën filozofike dhe mendore, periudhën shkencore e hulumtuese (siç e quan ai: periudha pozitive).

Mirëpo, më vonë, çështja e shkollës së humanizmit u pozicionua ndryshe. Lidhur me çështjen e njeriut dhe origjinalitetit të tij ka një mori problemesh. Këtu, në formë pyetjesh, shkurtimisht do të përmendim disa prej tyre:

Një prej tyre ka të bëjë me çështjen e lirisë, vullnetit, përgjegjësisë dhe detyrimeve

të njeriut. A thua vërtetë njeriu është qenie e lirë që ka vullnet? A ka ndonjë përgjegjësi që duhet patjetër ta kryejë? Natyrisht, nëse kërkon përgjigje në aspekt të logjikës islame, patjetër të themi: Absolutisht po! Në Kur’an ka një sure që mban emrin “El-Insan” (njeriu). Shkaku se pse kjo sure quhet “njeriu” është se në të flitet për njeriun, për të drejtat e tij, për lirinë dhe përgjegjësitë e tij.




Kjo sure fillon me ajetet:

“A mos i ka kaluar njeriut ndonjë pjesë e kohës kur nuk i është shpallur kurrgjë? Ne e kemi krijuar njeriun nga përzierja e farës për ta sprovuar dhe e kemi bërë që ai të dëgjojë dhe të shohë: Ne e kemi udhëzuar njeriun në rrugë të drejtë, qoftë si mirënjohës apo mohues”. (76:1-3)

Çka kërkon Krijuesi i gjithësisë nga njeriu? Ai për të kërkon lirinë. Allahu atë e ka krijuar si një qenie të lirë dhe me përgjegjësi që ka detyrat e veta. Madje, shpjegimi më i bollshëm për njeriun është dhënë në Kur’an ku theksohet se njeriu është “mëkëmbës i Allahut”. Asnjë libër nuk e ka lëvdur njeriun si Kur’ani:

“Dhe kur u tha Zoti yt melekëve: ‘Unë në tokë po caktoj një mëkëmbës!’”, ata i thanë: A po bën aty dikë që do të bëjë turbullira e gjakderdhje, kurse ne



Njeriu është dritare e botës shpirtërore. Në të vërtetë, njeriu në bazë të ekzistencës së tij ka zbuluar botën e shpirtërores. Shpirtërorja e njerëzorja, feja dhe njerëzorja janë të pandara.

A. Schulz

Ty të madhërojmë, të lëvdojmë dhe të lartësojmë? Unë di - tha Ai - atë çka ju s'e dini. Dhe ia mësoi Ademit emërtimet e të gjitha sendeve dhe pastaj ua paraqiti melekëve dhe u tha: 'Më tregoni për emrat e tyre, nëse flisni të vërtetën!' Ato i thanë: Qofsh lartësuar! Ne nuk dijmë përveç asaj që na ke mësuar Ti. Pa dyshim, Ti je i Gjithëditur, i Urtë". (2: 30-32)

Njeriu është manifestim i aktivitetit dhe i krijimit të Allahut.

Çështja tjetër që ka të bëjë me njeriun është fati dhe kënaqësitë e tij. Shumë njerëz kërkojnë kënaqësinë në mjedisin e jashtëm dhe vazhdimisht hulumtojnë për t'u kënaqur në jetë duke e shfrytëzuar atë. Ata janë njerëz që nuk e konsiderojnë veten njerëz, pra, nuk pranojnë se janë qendër kryesore e kënaqësisë dhe gëzimit (që gjenezën e kanë jashtë njeriut). Ku dëshiron të gjesh kënaqësinë dhe lumturinë, o njeri? Në lypje apo në drogë?

Qendra kryesore e kënaqësisë gjendet në vetë njeriun, prandaj duhet të krijojmë një baraspeshë në mes botës së jashtme dhe asaj të brendshme të vetë njeriut.

Njeriu është dritare e botës shpirtërore. Në të vërtetë, njeriu në bazë të ekzistencës së tij ka zbuluar botën e shpirtërores. Shpirtërorja e njerëzorja, feja dhe njerëzorja janë të pandara. Pra, duhet ta braktisim njerëzoren dhe fenë së bashku, ose nëse e pranojmë fenë, patjetër ta pranojmë edhe njerëzoren dhe anasjellas. Kjo është ajo kontradiktë për të cilën pohojmë se ekziston te shkollat omaniste (shkolla e humanizmit).

Ju, të cilët për filozofi tuajën keni zgjedhur filantropinë-njeridashjen, ndërkaq lëndë e besimit tuaj është njerëzimi, po ju pyesim: a ekziston te njeriu ndjenja të cilën mund ta quajmë mirësi, mëshirë ose ndihmë ndaj tjetrit?

Omanizmi përgjigjet në pyetjen: A thua vallë ekziston një ndjenjë e tillë apo jo? Ne pohojmë se një ndjenjë e tillë ekziston:

“Dhe i kemi treguar (njeriut) dy rrugë” (90:10).

Meqë njeriu si mëkëmbës i Allahut në tokë, është manifestim i mëshirës së Tij, njëherësh është edhe manifestim i mirësisë. Do të thotë se ekzistenca e njeriut për hir të vetvetes, nuk është vetëm egoizëm, por ajo përfshin edhe mirësinë, dëshirën për ndërtimin e botës, si dhe të ngritjes së vetëdijes morale.

Çka paraqesin këto ndjenja te njeriu? Ato janë manifestim i humanizmit. Ç’është ndjenja e falënderimit ndaj të mirëve dhe fisnikëve dhe ndjenja e urrejtjes ndaj të këqinjve, edhe pse ata janë njerëz të së kaluarës?

Omanizmi (shkolla e njerëzisë) përgjigjet në pyetjen: Nga burojnë këto ndjenja?

A thua vërtetë ju mendoni se aspekti i brendshëm i njeriut me atë burim të margaritarëve dhe vlerave është ashtu siç pohon materializmi se njeriu është një lloj makine? Për çdo makinë, pa marrë parasysh se sa është e komplikuar ose e madhe, vetëm mund të themi se është madhështore, e madhe, mahnitëse, por a kemi mundësi të themi se kjo makinë është fisnike, e shenjtë? Asnjëherë s’mund të themi se është fisnike, e shenjtë, dhe se ka një krenari të brendshme (shpirtërore). Ithtarët e deklaratës mbi të drejtat njerëzore si dhe filozofët komunistë që, në shumë fusha, janë ithtarë të omanizmit, si ka mundësi që të flasin për fisnikërinë dhe shenjtërinë e njeriut e të mos hulumtojnë shpirtin hyjnor që është i frymëzuar në të? Kur do ta kenë të qartë burimin dhe prejardhjen e atyre vlerave, atëherë do ta kenë të qartë edhe burimin e origjinalitetit të vetë njeriut.

“Allahu është burim i qiejve dhe i tokës!” (24:35).

Islami është një shkollë njerëzore që është themeluar në peshoren njerëzore. Kjo do të thotë se në Islam nuk ekzistojnë ato gjëra të cilat janë themeluar për diskriminime të gabuara në mes njerëzve. Me fjalë tjera, në Islam nuk ekzistojnë raca, vendi, gjuha, sepse sipas Islamit këto s’janë për matjen e vlerave njerëzore. Në Islam vlerat njerëzore janë peshore e vlerave të njerëzve. Islami që është shkollë e humanizmit dhe që e respekton humanizmin, konsideron se burimore janë edhe vlerat njerëzore, meqë konsideron se njeriu është burimor, origjinal. Ai konsideron se njeriu është origjinal meqë konsideron se edhe bota është origjinale, e kjo do të thotë se e pranon të Gjithëfuqishmin e të Madhërishtmin Zot:

“Ai është Allahu, që nuk ka tjetër zot përveç Atij, Sunduesi absolut, i Pastër, Paqedashës, garanton siguri, nën kujdesin e të Cilit është çdo send: i Forti, i Madhërishtmi Krenar. Qoftë i Lartësuar Allahu nga ata që i përshkruajnë shok!” (59:23)

Në bazë të kësaj, Islami është e vetmja shkollë njerëzore e cila mund të ekzistojë në bazë të logjikës së shëndoshë, ndërkas në botë nuk ekziston ndonjë shkollë tjetër njerëzore.

Të njihemi me suret e Kur'anit



23	Mu'minun	Mekase	118 ajete	1840 fjalë	4802 shkronja
----	----------	--------	-----------	------------	---------------

Emërtimi: Besimtarët

Shkaku i emërtimit: Është përshkrimi që u bëhet besimtarëve, si dhe shenjave të besimit në 11 ajetet e para të kësaj sureje.

Emra të tjerë: Nuk ka.

Përmbajtja e sures

- Atributet dhe vetitë e besimtarëve, si dhe parime të drejtësisë si, përulja në namaz, dhënia e zekatit, ruajtja e amanetit dhe e besës
- Shenjat e njohjes së Zotit, shenjat e mikrokozmosit dhe të makrokozmosit, krijimi i njeriut dhe mirësitë e Zotit
- E kaluara shembullore e profetëve Nuh (paqja qoftë mbi të!), Hud (paqja qoftë mbi të!), Musa (paqja qoftë mbi të!) dhe Isa (paqja qoftë mbi të!)
- Reagimi i popujve ndaj ftesës së profetëve
- Paralajmërimet logjike, të prera dhe të ashpra drejtuar arrogantëve për t'u rikthyer në rrugën e Zotit
- Çështje të kësaj jetë dhe të jetës së Përtejme, të gjykimit, të shpërblimit të besimtarëve dhe të ndëshkimit të jobesimtarëve
- Sundimi i gjithësisë nga Zoti dhe përhapja e urdhrit të Tij në çdo skaj
- Qëllimi i krijimit të njeriut

Renditja e sures

Sipas renditjes së tubimit, është surja e 23-të; sipas zbritjes, është surja e 73-të dhe ka zbritur pas sures "Enbija" dhe para sures "Fussilat".

Historitë e sures: Nuh: ajetet 23-29; Musa: ajetet 45-49

Fillimi dhe fundi

Fillimi: "Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët."

Fundi: "E ti thuaj: 'O Zoti im, më fal e më mëshiro, se Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve!'"

Mirësia e sures

Imam Sadiku ka thënë: "Ai që e lexon (a e këndon) suren "Mu'minun", sidomos çdo ditë të xhuma, fundin e jetës do ta ketë të lumtur dhe ai do të zërë një vend të lartë në Xhenet, bashkë me profetët dhe të dërguarit e Zotit."



Tregues i emrave myslimanë

Hajredin (Khajrud'dijn)	Hajredin, Haredin, Hajro	I miri i fesë
Hajrulla (Khajrull'llàh)	Hajrulla	Mirësia e Allahut
Hajri (Khajrij)	Hajri	Mirësi
Haki (Hakij)	Haki, Ki, Kiu,	I vërtetë
Halil (Khalijl)	Halil, Lil, Lilo, Lilë	Mik zemre, epiteti i Hazreti Ibrahimit [a.s.], mik i Allahut
Halim (Halijm)	Halim, Halo	I butë, dashamirës
Kimete (Kijemeteh)	Kimete	Vlerë
Latife (Letijfeh)	Latife	Dashamire
Lejla (Lejlàë)	Lejla, Lela, Laje	Nata e tridhjetë e hënës
Lutfije (Lutfij'jeh)	Lutfije, Fije	Dashamire
Mahmudije (Mahmùdij'jeh)	Mahmudije, Deje	E lavdëruar
Makbule (Makbùleh)	Makbule, Bule	E pranuar



Për mbrojtjen e fesë së pastër

Pejgamberët përcaktonin zëvendësit dhe mbrojtësit e Sheriatit pas tyre, edhe atë e përcaktonin në ditët e festave për t'i bindur njerëzit që t'i respektonin. Ende para se të vdiste

pejgamberi i Zotit, Ademi

(paqja qoftë mbi

të!), zëvendës i

tij u caktua

Shiti (paqja

qoftë mbi

të!) dhe pas

Musait (paqja

qoftë mbi

të!) u caktua

Jushe'a ibn

Nun (paqja

qoftë mbi

të!) dhe pas

vdekjes së

Davudit (paqja

qoftë mbi

të!) u caktua

Sulejmani

(paqja qoftë

mbi të!). Historiani

Mes'udi ka një libër me

titull **"Ithbatul-hudati"** dhe

aty thekson emrat e të porositurve dhe mbrojtësve të Sheriatit prej kohës së Ademit (paqja qoftë mbi të!) deri më sot.

Të theksojmë diçka nga porosia e Davudit (paqja qoftë mbi të!) për Sulejmanin (paqja qoftë mbi të!): Zoti i Madhëruar i zbriti Davudit (paqja qoftë mbi të!) një libër nga qielli, të vulosur me vulë ari e që përmbante 13 çështje, për të cilat Zoti i Madhëruar e kishte frymëzuar që ta pyeste të birin e tij Sulejmanin: "Nëse ai i shqyrton këto çështje, do të jetë zëvendësi yt."

Davudi (paqja qoftë mbi të!) thirri shtatëdhjetë priftërinj dhe shtatëdhjetë rabinë, e uli Sulejmanin para tyre dhe i tha: "O biri im, Zoti i Madhëruar më shpalli një libër nga qielli dhe aty ka çështje për të cilat

më urdhëroi që të të pyes

dhe nëse i zbërthen,

do të jesh zëvendësi

im pas meje."

Sulejmani i tha:

"Letë të pyesë

pejgamberi

(paqja qoftë

mbi të!)

për atë që

dëshiron

ndërsa unë i

mbështetem

vetëm Zotit të

Madhëruar."

Davudi

e pyeti: "O

biri im, cila është

gjëja më e afërt

dhe më e largët,

cila është gjëja

më e qetë dhe cila

më e shëmtuar, cila

gjë është më e mira dhe cila më e keqja,

cila gjë është më e pakta dhe cila më e

shumta, cilat janë dy gjërat që qëndrojnë,

cilët janë dy vrapuesit, cilat janë dy gjërat

e bashkuara, cilat janë dy gjërat e urryera,

cila është gjëja të cilën nëse e lyp njeriu

i falënderohet fundit dhe cila është gjëja

nëse e lyp njeriu, e qorton fundin?


Sulejmani (paqja qoftë mbi të!) u

përgjigj: "Gjëja më e afërt është Ahireti,

gjëja më e largët është kjo botë, gjëja më

e qetë është trupi me shpirt, gjëja më e


shëmtuar është trupi pa shpirt, gjëja më e



mirë është besimi (imani) pas mosbesimit (kufrit), gjëja më e keqe është mosbesimi (kufri) pas besimit (imani), gjëja më e paktë është siguria, gjëja më e shumë është dyshimi, dy gjërat që qëndrojnë janë qielli e toka, dy gjërat që lëvizin janë dielli e hëna, dy gjërat e përbashkëta janë nata e dita, dy gjërat që kundërshtojnë njëra-tjetrën janë vdekja e jeta, gjëja të cilën kur

falënderoi Zotin e Madhëruar dhe tha: "Zoti i Madhëruar më urdhëroi që t'ua lë zëvendës Sulejmanin!"

Beni Israilët reaguesh dhe thanë: "A një fëmijë do të na udhëheqë kur në mesin tonë kemi njerëz që janë më të mirë dhe më të ditur se ai?!" Kur dëgjoi Davudi (paqja qoftë mbi të!) për reagimin e tyre, e thirri parinë e Beni Israilëve dhe u



e lyp njeriu, falënderohet në fund është mëshira (kontrolli) në hidhërim, ndërsa gjëja të cilën kur e lyp njeriu, e qorton në fund është ashpërsia në hidhërim.

Kur e hoqën vulën, panë se përgjigjet ishin të sakta njësoj siç shkruhej në libër.

Priftërinjtë dhe rabinët i thanë: "Nuk do të pajtohemi pa e pyetur edhe për një pyetje, edhe nëse i përgjigjet do të jetë zëvendësi yt pas teje." Sulejmani u tha: "Pyetni dhe unë i mbështetem vetëm Zotit të Madhëruar. Ata e pyetën: "Çfarë është ajo që kur përmirësohet, përmirësohet i tërë njeriu dhe nëse prishet, prishet i tërë njeriu?" Ai u përgjigj: "Kjo gjë është zemra."

Pastaj Davudi hipi në minber, e

tha: "Dëgjova për reagimin tuaj, m'i sillni shkopinjtë tuaj dhe cili shkop do të lulëzojë, do të jetë zëvendës i imi pas meje!"

Ata i thanë: "Pajtohemi!" dhe i sollën shkopinjtë e tyre dhe Davudi (paqja qoftë mbi të!) u tha: "Le ta shkruajë secili prej jush emrin e vet në shkopi!". Kur i shkruan emrat e tyre, erdhi edhe Sulejmani, e solli shkopin me emrin e tij pastaj i futi në një shtëpi dhe e mbylli derën me dry dhe e ruajtën njerëz nga Beni Israilët. Pas namazit të mëngjesit, e çeli derën e i nxori shkopinjtë dhe vetëm shkopi i Sulejmanit kishte nxjerrë lule e gjethe (kishte lulëzuar), dhe kështu, pranuan përcaktimin e Davudit (paqja qoftë mbi të!).

A e dini se?

A e dini se?

Gjer më sot ka 45 përkthime të plota të Kur'anit në gjuhën angleze dhe 120 përkthime me sure të përzgjedhura.

A e dini se?

Në Kur'an ka një sure, ku në të gjitha ajetet e saj përmendet emri "Allah" dhe ajo është sure "Muxhadele".

A e dini se?

Kur'ani përmend lajme për të ardhmen siç është lajmi për mbrojtjen e Kur'anit prej çdo ndryshimi. (Hixhr, 9)

A e dini se?

71,6% e ajeteve të Kur'anit janë mekase dhe 28,4% janë medinase.

A e dini se?

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë se shëruesi i përsosur në ditën e Gjykimit është Kur'ani.

A e dini se?

Mrekullia e Kur'anit është "letërsia" që do të thotë se asnjë gjuhëtar apo letrar nuk është i aftë të sjellë Kur'an të ngjashëm me këtë që ndodhet në duart tona.

A e dini se?

Vëllazërimi është një prej çështjeve bazë në Kur'an siç thuhet në suren "Huxhurat" ajeti 10.

A e dini se?

Një prej mësimëve bazë të Kur'anit është uniteti siç thotë Allahu në suren "Ali Imran" ajeti 103: "Kapuni pas litarit (fesë) të Allahut dhe mos u ndani".



Ta kemi frikë Zotin

Njerëzit e vetpërmbytur kanë frikë nga Xhehenemi, të cilin nuk e shohin si një makth, por e shohin me syrin e zemrës dhe sigurisht, kuptojnë zjarrin flakërues të tij. Punët e tyre të mira i konsiderojnë diçka të vogël dhe përherë veten e konsiderojnë borxhli ndaj Zotit; nuk i varin shpresat në veprat e tyre të mira, por te mëshira e Zotit dhe nga frika e ndëshkimit. Buzët e tyre këndojnë për Zotin dhe zemrat e tyre mbushen plot me dashuri për Zotin. Krijimin e gjithësisë e konsiderojnë si shenjë të fuqisë së Tij. Ç'është kjo bindje dhe përlulje që ka pushtuar gjithë qenien e tij, që e ngre atë në frikën ndaj Zotit?! Kur qëndron përballë pranisë madhështore të Zotit, gjithë trupi i njeriut dridhet; frika ndaj Zotit e lë pa ndjenja dhe nëse nuk do të ishte vdekja që ka caktuar Zoti për të, shpirti i tij sa hap e mbyll sytë, do dilte nga trupi dhe do t'i dorëzohej Krijuesit të vet. Por, besimtari nëpërmjet frikës ndaj Zotit arrin në bindje dhe përlulje dhe pikërisht në sajë të tyre ai fiton frikën ndaj Zotit. Ajo që duhet theksuar, është vazhdimi i kësaj rruge e cila duhet mbrojtur me seriozitet dhe përpjekje.

Disa vështirësi

Ndonjëherë jeta e besimtarit bëhet e vështirë nga shoqëria, por ai lehtësohet kur i ndjen begatitë e Zotit të Madhëruar. Ai nuk duhet të preket ose të mjerohet nga ajo që përjeton dhe kur sheh zullumqarët se si jetojnë jetë të begatshme e të lumtur. Atyre u është dhënë kjo botë dhe kënaqen me të mirat e saj, mirëpo, e gjithë kjo nuk zgjat dhe i ngjan një ëndrrë që zhduket kur zgjohesh nga gjumi. Çdo kriminel do të dëshironte ta jepte krejt botën vetëm të shpëtonte nga dënimi por... Në këtë kontekst, Kur'ani thotë: ***"Krimineli dëshiron sikur të paguante dënimin e asaj dite me bijtë e vet, me gruan dhe me vëllain e vet, edhe me të afërmit e tij, tek të cilët mbështetej, edhe me krejt çka ka në tokë, e vetëm të kishte shpëtuar!"*** (Mearixh, 11-14)

Transmetimi vijues konfirmon atë që theksuam më lart: Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: Musai ka thënë: Ndoshta robi yt besimtar përjeton vështirësi në këtë botë dhe kur i hap derën e Xhenetit, Zoti i Madhëruar i thotë atij: "O Musa, këtë e kam përgatitur për të!" Musai i tha: "O Zoti im, qofsh i Lartësuar

dhe i Madhëruar, nuk do të mjerohet edhe sikur të ishte duarkëputur e këmbëkëputur dhe sikur të zvarritej në fytyrë tërë jetën prej kohës së krijimit e deri në ditën e Kiametit. Pastaj vazhdoi: "O Zoti im, robi yt jobesimtar jeton më mirë në këtë botë" dhe kur ia hap derën e zjarrit, Zoti i Madhëruar i thotë: "O Musa, këtë e kam përgatitur për të!" në atë moment, Musai tha: "O Zoti im, qofsh i Lartësuar dhe i Madhëruar, sikur ta kishte tërë botën prej ditës së krijimit deri në ditën e Kiametit, nuk do të përjetonte asnjëherë ndonjë mirësi nëse këtu e ka fundin!".

Inteligjenca

Islami është fe e inteligjencës, arsyes dhe



Zoti i Lartësuar këtë inteligjencë ia ka kërkuar robit të vet. Shenjat e inteligjencës ia ka lënë në vullnetin dhe detyrat e njeriut që çdokush që dëshiron, të përfitojë prej saj dhe të lumturohet në dritë dhe në begati. Inteligjenca në Kur'anin famëlartë është provuar shpesh dhe Zoti i Madhëruar robtë e tij më të mirë i ka paraqitur me përshkrimin **inteligjentë** të cilëve u drejtohet kryesisht Kur'ani, madje edhe në pranimin e shenjave të Zotit nuk ndjekin ndjenjat e verbra, por

me zgjuarsia dhe inteligjencë hulumtojnë mirë shenjat e Zotit dhe bëhen përmendës dhe vigjilentë. Kur'ani famëlartë në ajetin 73 të sures "Furkan" thotë: "...**Edhe ata që kur këshillohen me ajetet e Kur'anit të Zotit të tyre, nuk u kthejnë shpinën si të shurdhët e të verbër.**"

Kur'ani famëlartë, ky Libër plot mirësi dhe begati, thesaret e çmueshme dhe kuptimin e vetë thellë ia kushton vetëm atyre njerëzve të cilët kanë mend dhe intelekt dhe në sajë të inteligjencës së tyre meditojnë rreth shenjave të Zotit: «Është Kur'ani i madh, ky Libër i bekuar dhe plot dinjitet që ta zbritëm ty me qëllim që të mendojnë rreth ajeteve të tij dhe njerëzit e mençur të përmendin të vërtetat e tij.» Islami dënon ashpër imitimin e verbër dhe ndjenjat e përkohshme dhe i fton myslimanët në mençuri dhe në mendjempërhtësi në të gjitha punët, ashtu sikurse Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) falë inteligjencës dhe argumenteve të qarta u zgjodh profet.

Të jesh i kënaqur

Kënaqësi do të thotë që njeriu të jetë i kënaqur me atë që i ofrohet në jetë. Nëse kënaqësia shndërrohet në një gëzim që përmbush nevojën e njeriut, atëherë ajo mund të



përkufizohet si një moral njerëzor, mirësi e madhe dhe shenjë e afritit me Zotin e Lartësuar. Kënaqësia e njeriut që i është dhënë në jetën e tij për të përmbushur një nevojë, në të vërtetë, është kënaqësi nga ajo gjë të cilën Zoti e ka paracaktuar sepse ai ka thënë: "Ai është që pasuron dhe varfëron."

Të ndihesh i kënaqur me atë që të ka dhënë Zoti, në të vërtetë është bindja ndaj Zotit dhe afrimi drejt Tij. Një kënaqësi e tillë buron nga bindja ndaj Zotit dhe jo kënaqësi që rrjedh nga varfëria dhe pamundësia. Ai njeri, i cili është i kënaqur, u jep të tjerëve nga pasuria e vet, ai ia ka dalë mbanë që të futet në konceptin e humanizmit dhe i është afruar Zotit. Prandaj, njeriu dorështrenguar ndaj vetvetes, familjes dhe të afërmeve të tij, nuk është i kënaqur. Ai atë që nuk i nevojitet më për vete e shtrëngon fort dhe nuk ua dhuron të tjerëve, por njeriu, i cili përdor pasurinë e tij sa për të zgjidhur problemin e vet dhe pjesën tjetër ia fal nevojtarëve, në këtë rast mund të themi se ai është një njeri i kënaqur.

Falja

Falja, është një cilësi e admirueshme dhe nuk do të thotë të mbyllësh njërin sy ndaj gjynahit të kryer nga një person, kjo për arsye frike. Por falje quhet kur ti fal dikë megjithëse ke forcën dhe fuqinë për t'u hakmarrë ndaj tij. Zoti në përshkrimin e Madhështisë së Vet thotë: **"Nëse paraqitni ndonjë të mirë ose e fshihni atë, ose i falni ndonjë të keqe (dikujt), Allahu i Plotfuqishëm fal shumë."** (Nisa, 149)



Zoti, si një Falës i Madh, ka fuqinë dhe forcën për t'u hakmarrë, por me qëllim që të theksojë cilësinë e faljes të njeriut, i kërkon atij që të falë të këqijat që i kanë bërë të tjerët. Atëherë, falja e gabimeve të të tjerëve është e lavdërueshme dhe konsiderohet mirësi, kur falësi të evitojë hakmarrjen. Mirëpo, falja e gabimit dhe e veprës së keqe, duke pasur parasysh edhe mundësinë për t'u hakmarrë, qëllimi i faljes nuk duhet të jetë ndryshe nga ai që u tha më sipër.

Kur'ani famëlartë në suren "Nur", ajeti 22 thotë: "Të ndershmit dhe të pasurit nga ju, të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmeve, të varfërve dhe atyre që për hir të Allahut lanë vendlindjet e tyre, po le t'ua falin (gabimin) dhe mos t'ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që Allahu t'ju falë ju? Allahu fal dhe mëshiron shumë."

Muhamed Reza Aram

Darvini dhe idea e tij



arvini thotë se njeriu dhe kafshët janë specie nga e njëjta prejardhje.

Kjo idenukemohonekzistencën e Allahut. Për këtë edhe Darvini e pohon se Allahu ekziston. Por janë në kundërshtim me thëniet e feve të cilat dëshmojnë Ademin (paqja qoftë mbi të!). Pyetja është: Ku është argumenti i thënieve të Darvinit?

A e pa ai fillimin e krijimit?

Ai do të thoshte: Jo.


Në çfarë argumentesh dhe faktesh mbështetet ai për këto thënie?

Ai do të thoshte: Dituria.

Atëherë, cila është ajo dituri e cila të çoi në këtë teori?

Ai do të thoshte: Ngjashmëria e njeriut me majmunin.

Ngjashmëria nuk është tregues për asgjë sepse nëse do ishte e tillë atëherë kjo shtëpi është e ngjashme me atë shtëpi, ky yll është i ngjashëm me atë tjetrin dhe ky njeri i ngjan atij njeriut



tjetër... A mund të thuash se një prej tyre është origjinali i tjetrit?

Pastaj, njeriu i ngjan majmunit dhe nuk ke thënë se majmuni është origjinali i njeriut dhe as nuk thua: Njeriu është origjinaliteti i majmunit?

Ai do të thoshte se universi është në ngritje.

Ku është argumenti yt?

A nuk është njeriu ai, i cili, kur moshohet fillon ta humbasë mendimin?

A nuk janë bimët ata që zverdhen dhe thahen? A nuk janë kafshët ato që zhduken dhe bëhen dhe...?

Ky është njeriu dhe majmuni... Ku është argumenti për ariun dhe luanin, mizën dhe mushkonjën, qenin dhe derrin, zogun dhe peshkun?

Themise shndërrimi i majmunit në njeri, a nuk ka nevojë për dituri, fuqi dhe eksperiencë? Nëse thuhet "Jo", atëherë a ka nevojë shndërrimi i leshit në fije për dituri, fuqi dhe eksperiencë?!

Nëse thuhet "Po", kush është ai dijetar i cili e shndërroi majmunin në njeri? A është natyra injorante?!

Apo është Allahu?

Mohuesi i Zotit dhe i Sheriatit të Tij e mendojnë shumë njeriun e pastaj thotë se patjetër do të kthehemi tek Ai ku nuk mund të fshihet prej Tij.

Jetova kështu derisa u bëra doktor dhe udhëtova në zonën e minierave në jug të qytetit Vilz.

Unë pashë mrekullinë e lindjes së njeriut dhe u ula pranë të vdekurve. Në errësirë dëgjova fëshfëritjet e pendëve të vdekjes. Mendjemadhësia m'u largua dhe fillova të besoj në Zot.

Po ashtu, pashë punëtorët, të gjithë besonin në Zot. Nuk kalonte javë pa ndodhur diçka që ishte në përputhje me besimin dhe mbështetjen e tyre në Zot.

Kurrë nuk do ta harroj atë ditë, sa të jem i gjallë!

Një ditë ndodhi një shpërthim i tmerrshëm, i cili çoi në shembjen e minierës dhe 14 punonjës mbetën të bllokuar pesë ditë aty.

Banorët e fshatit i faleshin Zotit për ta. Dhe së fundi, personat e shpëtimit çanë rrugën për të shkuar tek të bllokuarit. Ata dëgjuan lutje frikësuese që dilnin prej murit shkatërrues. Ishin zërat e punëtorëve të cilët thonin: O Mëshirues, o Mëshirbërës.

Ata u nxorën të gjallë prej andej dhe ishin të rraskapitur. Rreth tyre erdhën me mijëra punëtorë të cilët thonin: «O Mëshirues, o Mëshirbërës në çdo kohë».

Kur u afrova pranë atyre të rënëve, ajo dallgë e lutjes pushtoi brendësinë time.

Ai është fakt se besimi i njeriut vërtet kalon çdo cak.

Një i pafe beson Zotin

Doktor A. Xh. Krotin: Isha i pafe kur studioja për mjekësi në Universitetin e Londrës.

Kur qëndroja para trupit të njeriut në dhomën e operacionit e ndieja veten sikur ndodhesha para një rrjeti shumë të habitshëm dhe në të njëjtën kohë unë mendoja për shpirtin e përhershëm tek Zoti.

Buzëqeshja tallëse dukej në fytyrën time dhe thoja se kjo gjë ishte legjendë e vjetër. Për këtë, shumë studentë të universitetit ishin të një mendjeje me mua.

Si u zbuluan ujërat?

Krutin: Para disa vjetësh, kur isha në Londër, ngrita një klub për të rinjtë dhe ftova një dijetar që merrej me konceptin e jetës me qëllim që të mbante një fjalim.

Ky dijetar zgjodhi fjalimin me subjekt «Fillimi i botës». Ai bisedoi duke përdorur mënyrën e dijetarit jobesimtar dhe filloi t'i cilësonte kohët «El – lajun», të mëparshme të historisë dhe se si toka me kalimin e kohës u shndërrua prej tymi në fusha, kodra etj. Sipas tij, toka kishte qenë e rrethuar nga ujërat e oqeanëve; dallgët ngriheshin

dhe uleshin mbi shtresën e tokës; shtresa e tokës u formua si pasojë e reaksioneve kimike natyrore dhe ky reaksion së bashku me llumin dhe mbeturinat e tjera çuan në krijimin e sipërfaqes tokësore në të cilën ne



jetojmë.

Mbi këtë tokë u duk jeta e parë në formën e «protoplazmës».

Kur mbaroi flalimin e tij, të pranishmit duartrokitën.

Por një nxënës u ngrit. Ai dukej i nervozuar dhe e pyeti atë!

O zotëri, të më falësh! Ti vërtet na fole rreth dallgëve të larta të cilat përplasen me bregun, por ama si u gjet i gjithë ky ujë? Ai pushoi i hutuar dhe fytyra iu skuq.

Para se të përgjigjej, të pranishmit filluan të qeshnin. Vërtet, idenë e tij të hekurt e shkatërroi pyetja e nxënësit të vogël.

Marrë nga “Njohje Islame”

FJALË TË URTA

*Edhe bari i njëmë digjet nëpër të
thatë. (populli)*

*Jeto sikur do odesësh nesër dhe
mëso sikur do jetosh gjithmonë.
(populli)*

*Kalliri me bukë e mban kokën
poshtë, ai bosh... përpjetë.
(populli)*

*Më mirë një vezë sot, sesa një
pulë mot. (populli)*

*Me një nuse nuk bëhen njëqind
dhëndurrë. (populli)*

*Mos hiq petullat me duart e
tjetrit. (populli)*

*Njeriun që ka shumë fjalë, edhe
një i shurdhët e mund. (populli)*

*S'mbahet shtëpia me miell hua.
(populli)*

*Të bënte çdo mizë mjalte, haça
dhe unë. (populli)*

*Fjalët e keqdashësit janë si
qymyri, që edhe po s'të dogjën, të
uxijnë.*



Bismilah

Bismilah
Me këtë fjalë zgjohem çdo ditë në mëngjes
Bismilah
Çdo ditë i lutem Zotit e ndihmë nga Ai pres
Bismilah
Çdo punë të mirë me mbështetjen e Tij e filloj
Bismilah
Në plotfuqinë e Tij me zemër të pastër besoj
Bismilah
Për mirësitë e Tij çdo ditë më shumë e adhuroj
Bismilah
Falë i qofsha Atij për begatitë në këtë jetë
Bismilah
Kjo fjalë është çelësi i lumturiisë për çdo besimtar të
vërtetë.

Lirie Alzeneli

(nxënëse në klasën e Kur'anit në fshatin Rad të Durrësit)



Sa të kushton loti, o njeri?



Sa do të doja rininë të përjetoja,
me buzëqeshje të rifilloja,
me hapa të shpejtë në xhami të shkoja
Në rreshtin e parë duke pritur shumë pleq
e një hap pas tyre të qëndroja
Të shkoja përsëri në shtëpi e gjithçka të tregoja:
Sot Islamin e lavdëruam
Allahun e adhuruam
Muhamedin e kujtuam
Sa njerëz janë prej meje
selamin e fundit për të më dhënë e pastaj të më harrojnë
Sa të kushton loti, o njeri?
Lotin e kanë shuar e sytë i kanë verbuar.
Për Allahun lotin kurseve?
Kur e kërkoje ti
atëherë nuk jetoje
se në Xhehenem përfundove.



PASTËRTIA

Pastërtia është pjesë e etikës në Sheriatin islam. Islami interesohet shumë për pastërtinë e trupit, të rrobave, të shtëpisë etj. Nuk lejohet që mjediset të ndoten. Nuk lejohet neglizhenca për pastrimin vetjak; papastërtia e trupit tënd mund të shqetësojë të tjerët. Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Vërtet, Allahu është i Pastër dhe e do pastërtinë. Allahu është i Këndshëm dhe e do të këndshmen.” “Pastërtia është pjesë e besimit.”*

“E para gjë për të cilën njeriu do të japë llogari është pastërtia.”

“Pastrohuni me sa të mundeni! Vërtet, Allahu e ngriti Islamin mbi pastërtinë dhe në Xhenet do të hyjnë vetëm të pastërtit.”

“Islami është i pastër, prandaj pastrohuni, sepse në Xhenet do të hyjnë vetëm të pastërtit.”

“Allahu e do adhurimin që bëhet me pastërti.” Transmetohet se Imam Rizai ka thënë: *“Prej moralit të të dërguarëve është pastërtia.”*

Pastërti të detyrueshme të myslimanit janë abdesi, gusuli, tejemumi. Këto sqarohen në librat e fikhut (jurisprudencës).

Adhurimet nuk pranohen nëse nuk i zbaton detyrat e Sheriatit ashtu siç duhet. Për etikën dhe për rregullat e adhurimeve do të flitet në dy mësimet e ardhshme.

1- Pastërtia e trupit

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Pastrojini këta trupa, Allahu ju pastroftë, sepse me njeriun e pastër qëndron meleku që e shoqëron atë. Kur vjen nata, meleku i lutet Zotit: “O Zot, fale robin Tënd,*



sepse ai ka ndenjur i pastër.” “Mjerë njeriu i papastër!” “Të papastërit janë të shkatërruar.”

Transmetohet se Imam Aliu (Allahu ia ndriçoftë fytyrën!) ka thënë: *“Lahuni e hiqeni erën e keqe e neveritëse. Mbajeni veten pastër, sepse Allahu nuk e do te robtë e Tij papastërtinë, e cila shqetëson të tjerët.”*



2- Rregullat e tualetit

Imam Aliu (Allahu ia ndriçoftë fytyrën!) ka thënë: *“Lum ajo shtëpi që ka hamam! Në të kujtohet zjarri dhe largohen papastërtitë.”* Në një hadith të Imam Sadikut përmenden rregullat e hyrjes në hamam. Para se njeriu të hyjë në hamam të thotë: *“O Zoti im, largoji prej meje ndyrësitë dhe papastërtitë! Ma pastro trupin dhe zemrën!”* Kur të hedhë ujë të ngrohtë mbi trupin të thotë: *“I kërkoj mbrojtje Allahut prej zjarrit dhe i lutem Atij të më fusë në Xhenet.”* Pasi të lahet,

të fshihet e të vishet, të thotë: *“O Zoti im, më vish devotshmërinë dhe ma largo hipokrizinë.”*

Një prej rregullave të hyrjes në hamam është mbulimi.

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Askush prej jush të mos hyjë në hamam i zhveshur.”*

Po ashtu, transmetohet se Imam Sadiku ka thënë: *“Prej rregullave është që i rrituri të mos hyjë me fëmijën e tij në hamam e t'i shohë pjesët e turpshme.”* *“Ai që hyn në hamam i veshur, Allahu do ta mbulojë me mbulesën e Tij.”*

Transmetohet se Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Vërtet, Allahu i Lartësuar e ka përbuzur për ju o ymet të hyni në lumë të zhveshur.”* Kjo do të thotë se mbulimi i pjesëve të turpshme është detyrë për të gjithë, jo vetëm kur lahem, por kudo.

Prej etikës së pastrimit është edhe heqja e qimeve nga disa vende të trupit, si poshtë sqetullave dhe në pjesët intime. Është mirë që këtë veprim njeriu ta kryejë çdo dy ose çdo katër javë. Po e bëri pas dyzet ditëve, për të nuk ka të mira.

3- Pastrimi i rrobave

Para se Islami të interesohet për formën, ngjyrën a llojin e veshjes, interesohet më së pari për pastërtinë e tyre.

Në jetëshkrimin e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thuhet se një ditë Profeti kishte parë një burrë të veshur me rroba të papastra. Profeti i kishte thënë: *“A nuk ka gjetur ujë ky njeri që të lajë rrobat e tij?”*

Në një hadith të Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thuhet: *“Ai që blen rroba, t'i lajë ato.”*

Një ditë Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i tha Aishes:



“O Aishe, laji këto dy rroba. A nuk e di se edhe rrobat lartësojnë (bëjnë tesbih) dhe kur janë të papastra ato e ndërpresin tesbihun?”

Imam Aliu (Allahu ia ndriçoftë fytyrën!) ka thënë: *“Rrobat e pastra e largojnë hidhërimin dhe zemërimin dhe janë të vlefshme për namaz.”*

Imam Sadiku ka thënë: *“Rroba e pastër e zemëron armikun.”*

Në disa hadithe të transmetuara nga Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thuhet se rroba më e mirë është ajo me ngjyrë të bardhë. Në të shumtën e kohës Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka veshur rroba të bardha.

Për këtë ai i porosiste shokët e tij: *“Vishuni me rroba të bardha, sepse ajo është më e pastër dhe qefinosini të vdekurit tuaj me të.”*

Rrobat prej pambuku dhe lini janë më të mirat. Sheriati islam e ka ndaluar mëndafshin për meshkujt, por e ka lejuar për femrat.

Imam Aliu (Allahu ia ndriçoftë fytyrën!) ka thënë: *“Vishni rroba pambuku, sepse rrobat e pambukut kanë qenë veshje e të dërguarve.”*

Transmetohet se Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Është e ndaluar për meshkujt e ymetit tim veshja e mëndafshit dhe mbajtja e floririt. Ato janë të lejueshme për femrat.”*

Dihet se qëllimi kryesor i veshjes është mbulimi dhe paraqitja me pamje të kënaqshme. Kësisoj,

veshja për t'u mburrur nuk është e pëlqyeshme në Sheriat. Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Atë që vishet për t'u mburrur dhe për t'u dukur tek të tjerët, nuk do ta shohë Allahu, derisa ai t'i zhveshë ato rroba.”*

Islami thotë: **“Pastërtia është prej besimit.”** Është detyrë e myslimanëve që të zbatojnë rregullat e Sheriatit për pastërtinë. Ata duhet të pastrojnë trupin, rrobat, të krehin flokët dhe t'i shkurtojnë ato.

PANAIRI I LIBRIT NË TIRANË

Më 11. 11. 2010 u hap Panairi i 13-të i Librit në Pallatin e Kongreseve. Stenda jonë u vizitua nga njerëz të njohur, të cilët shfaqën interes për librat e paraqitur. Dashamirës të teksteve islame vizituan çdo ditë stendën tonë. Ne shpresojmë që vitin tjetër do të arrijmë t'u ofrojmë edhe më shumë botime të reja lexuesve të literaturave fetare islame.



Të njihemi me librat e rinj

Lexues të dashur të revistës Këshilla, ndër botimet tona të reja janë revista **Drita e Kur'anit**, nr. 1/2 dhe 3/4, 2010 ku janë pasqyruar artikuj shkencorë mjaft të vlefshëm për të gjithë ata që duan të mësojnë më shumë mbi mrekullinë e Kur'anit dhe revista për fëmijë **Selam** me dy numrat e fundit të saj, nr. 6 dhe nr. 7.



“KUR’ANI DHE LUTJA”



Ky sesion u organizua nga Fondacioni i Kur’anit në bashkëpunim me Universitetin Ndërkombëtar “Al Mustafa”, më datë 5 Shkurt 2011, në Tirana International Hotel.

Hapja u bë në orën 9:30. Në fillim u këndua himni kombëtar, pastaj vijoi me lexim Kur’ani nga Hfz. Aziz ef. Allii. Drejtori i Fondacionit, Muhamed Reza Haxh Khezer tha fjalën e mirëseardhjes. Ndër të tjera, u bë paraqitja e 10 viteve të aktiviteteve të Fondacionit të Kur’anit në Shqipëri nga znj. Vjollca Feza (Karaj). Aktiviteti u pasua nga **fjalët përshëndetëse** të dr. Ali Amoui, Ambasadori i Republikës Islamike të Iranit, h. Shaban Saliaj, Myfti i Tiranës dhe përfaqësues nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, dr. Enver Bytyçi, Drejtor i Marrëdhënieve me Publikun pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Viktor Sharra, përfaqësues i Komitetit Shtetëror për Kultet, Dervish Mikeli, përfaqësues i Komunitetit Bektashian, MonsinJOR George FrenDO, përfaqësues i Kishës Katolike, Ajatollah dr. A’rafi – Rektor i Universitetit Ndërkombëtar “Al Mustafa”. Një moment kryesor i këtij aktiviteti ishte edhe ceremonia e **nderimit të një prej**

përkthyesve të Kur'anit në gjuhën shqipe, H. Selim Stafa. Në vijim, pas fjalëve përshëndetëse, u mbajtën kumtesat në lidhje me temën. I pari ishte z. Xhemal Balla (Shqipëri) me temën **Kur'ani, lutja dhe mbështetja te Allahu. Më pas**, prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi (Kosovë) me temën **Ndikimi psikofizik i lutjes kur'anore në shëndetin e njeriut**; z. Bedri Telegrafi, zv/drejtor i AIITC (Shqipëri) me temën **Psikologjia e lutjes**; hafiz ef. Aziz Alili, Kryeimam i Bashkësisë Islame të Kroacisë (Kroaci) me temën **Kur'ani, lutja dhe gnostika**; h. Selim Stafa (Shqipëri) me temën **Njohje rreth librit "Sahife Saxhadije"**; prof. dr. Gjergj Sinani, Pedagog i Filozofisë në Universitetin e Tiranës me temën **Lutja në disa prej feve primitive dhe monoteiste**; prof. dr. Bedri Bylyku, Kryetar i Shoqatës së Miqësisë Shqipëri - Iran (Shqipëri) me temën **Lidhja mes lutjes dhe veprës dhe anasjelltas**; z. Ermal Bega (Shqipëri) me temën **Lutja dhe modernizimi. Së fundi, u bë paraqitja e xhuzit të dytë të Kur'anit. Për të gjithë të ftuarit u shtrua një drekë falënderimi.**





Selam


Të dashur miq të vegjël të revistës “Selam”, meqë ju tashmë jeni bërë edhe 1 vit më të mëdhenj, siç ka kaluar 1 vit nga themelimi i revistës sonë, ne kemi menduar për ju një vend të posaçëm brenda revistës “Këshilla”, por tashmë me emrin “Këshilla për fëmijë”.



*Me emrin e
All'lahut, të
Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit*

Selam

Ky numër i revistës "Selam" sjell afërsinë e Profetit tonë, Hazreti Muhamedit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në të vërtetë, kur kam qenë e vogël në moshën e disave prej jush, kur shihja se për krishtlindje festonin dhe për ditëlindjen e Hazreti Isait (*Paqja qoftë mbi të!*) ndriçonin rrugët, gëzohesha. Mirëpo, kur vinte ditëlindja e Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shihja që nuk kishte rrugë të ndriçuara dhe festime dhe mërzitesha shumë. Thoja me vete: Profeti ynë (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është profeti i mëshirës, ai është profeti i fundit ku librat qiellorë si Teurati e Unxhilli kanë lajmëruar për ardhjen e tij. Ai i donte të gjithë profetët e Zotit. Për mendimin tim është ditëlindja e të gjithë njerëzimit. Pra, o njerëz gëzuar ditëlindjen e Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)!



MORALI I PROFETIT MUHAMED

*(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin
mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Të flasësh për Profetin do të thotë të përmendësh njeriun më të përkryer. Të përmendësh emrin e tij, ke përmendur drejtësinë, mëshirën, dashurinë, fisnikërinë, moralet e përkryera etj.

Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është krijesa më e përsosur. Ai është mëshirë për të gjithë botën. Ai qëndroi në majat e larta të moralit. Ai është vula e profetëve dhe nuk vjen profet pas tij. Mrekullia e tij e përjetshme është Kur'ani. Në literaturën islame thuhet se Profeti ka qenë "Kur'ani folës", që do të thotë se Libri i Allahut të Madhëruar ishte i kristalizuar tek Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Historia islame përmban shumë shembuj që tregojnë për moralin e lartë të Profetit Muhamed *(Paqja dhe*



bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Unë do të përmend një prej tyre. Kur Profeti shkoi në Taif për të ftuar popullin e atij vendi në Islam, banorët e Taifit e fyen, e shanë dhe jo vetëm kaq, ata u thanë fëmijëve të tyre që ta



qëllonin me gurë Profetin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), derisa e gjakosën. Kur doli nga Taifi, u ul në hijen e një peme dhe tha: "O Zot, udhëzoje popullin tim, se ata janë të paditur." Këtu duket qartë, dashuria, durimi dhe mëshira e Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ai nuk lutej për shkatërrim, por lutej për udhëzim, nuk hakmerrej e nuk nxitonte kur e fyenin. Por, të gjitha këto i priste me zemërgjerësi dhe me durim. Nëse duam të jemi të lumtur, duhet të ndjekim moralin e Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)



GRUAJA E MOSHUAR DHE HAJDUTËT

Na ishte se ç'na ishte... Para shumë vitesh, në një fshat jetonte një grua bujare me dy djemtë e saj. Gruaja bujare punonte në tokën që i kishte mbetur trashëgim nga bashkëshorti i saj, nga mëngjesi deri në darkë. Kështu, ajo mendohej që të mbushte barkun e djemve të saj. Kaluan vite dhe djemtë e gruas bujare u rritën. Secili prej tyre u bë i zoti i vetes. Hasani, i gjatë dhe me trup të bukur. Hysejni i shëndoshë. Dhe nëna



42

e tyre tashmë ishte plakur. Nuk mund ta punonte më tokën si më parë. U ul në një qoshe dhe filloi të mendonte. Vendosi që djemtë t'i martonte. Nuset do t'i bëheshin ndihmë në shtëpi dhe djemtë do të mblidhnin mendjen e do të punonin tokën. Gruaja e moshuar këtë



çështje e bisedoi me djemtë e saj. Djemtë nuk thanë gjë. Por, ishin të gëzuar. Morën belin e kazmën dhe iu përveshën tokës. Nga ana tjetër, gruaja e moshuar e lumtur po lyente flokët e saj me këna. Veshi rrobat më të mira që kishte. Përveshi mëngët dhe u nis për të kërkuar nuse për djemtë. Sa në një shtëpi në tjetrën shkante. Ë ra fshatit rreth e qark deri sa gjeti dy motra të cilat ishin shumë bujare dhe të mira. Kur mori përgjigjen pozitive të vajzave, u nis menjëherë drejt djemve të saj. Hasani dhe Hysejini ishin të zënë duke punuar tokën. Atë vit djemtë aq mirë i kishin qëndruar tokës mbi kokë saqë kishin marrë prodhim më shumë se çdo vit tjetër. Djemtë, pasi dëgjuan këtë lajm, ngarkuan gomarin me perime dhe u nisën për t'i shitur në qytet. Kur u kthyen në darkë të lodhur e të raskapitur i dhanë nënës një qese me monedha ari që t'i përdorte në kohën e dasmës. Gruaja e moshuar e fshehu qesen me monedhat e arit nën tokë, në një cep të dhomës. Ë hodhi një qilim të vjetër sipër dhe shkoi të flinte me mendjen e qetë.

Nga ata tjetër, nëpër fshat filluan të dëgjoheshin zëra se gruas së moshuar po i ecte mbarë me prodhimet. Tashmë, të gjithë e dinin se gruaja e moshuar me shitjen e prodhimeve duhej të kishte disa qese me florinj. Një natë prej netësh, kur gëzimi kishte arritur në majë dhe nëna po festonte dasmën e djemve të saj, dy hajdutë u nisën drejt shtëpisë së saj. Ndërkohë që të gjithë ishin në gjumë, gruaja e moshuar dëgjoi zërin e hajdutëve që u hodhën nga muri në oborrin e shtëpisë. Deshi që të zgjonte djemtë që po flinin në dhomën tjetër, kur hajdutët u futën në dhomën e saj. Gruaja e moshuar mendoi me vete se po të thërriste, hajdutët mund ta sulmonin. Më mirë mendo ndonjë rrugë tjetër më të mirë, - tha me vete. Kështu bëri dhe ja dëgjoi e mirë i erdhi në mendje. U shtir sikur ishte në gjumë. Filloj të fliste në gjumë: Of, sa ftohtë që bën... Hasan më sill një batanije... Hysejini më sill një batanije... Hasan dhe Hysejini! - e thoshte me të madhe që ta dëgjonin e të shkonin që ta ndihmonin. Hajdutëve që



ishin të zënë duke kërkuar thesarin iu futën këmbët në një këpucë. Vrapuan dhe gjetën një batanije e ia hodhën gruas sipër. Hajdutët filluan që të kërkonin sërish e ta kthenin dhomën mbrapsht. Gruaja e moshuar donte që t'i vinte në dijeni djemtë e saj për atë që po ndodhte dhe filloi të thërriste: Po vdes nga vapa. Hasan, Hysejn më ndihmoni. Hajdutëve u iku gjaku. Menjëherë vrapuan drejt gruas dhe ia hoqën batanijen. Gruaja e moshuar në errësirë e shikonte që krevatët ishin bërë rrëmujë dhe sërish me zë më të lartë thirri: Hasan, jam shumë e etur. Hysejn më pihet ujë. Djemtë po flinin aq rëndë saqë nuk i dëgjonin këto thirrje. Një prej hajdutëve u nevrikos dhe i tha në vesh tjetrit: Çfarë shansi, ku na u gjet sonte kjo plakë. Shpejt merr një gotë ujë dhe jepja në dorë. Hajduti tjetër vrapoi dhe gjeti një gotë me ujë dhe ia dha gruas në dorë. Këtë herë hajdutët ngritën qilimin. Gruaja e moshuar nuk po duronte më sepse ishin mjaft afër qeses së floririt. Mendoj me vete se çfarë të bënte. Për këtë arsye, ajo me zë më të lartë se më parë bërtiti: Of, edhe këto mushkonjat. Hasan, më rrjepën mushkonjat. Hysejn më rrjepën mushkonjat. Dhe filloi që të kruante kokën, fytyrën, duart dhe këmbët. Hajdutët që tashmë duart i kishin nën tokë dhe në errësirë e kishin ndier qesen e floririt, nxorrën duart dhe filluan t'i lëviznin sa në një anë në tjetrën që të qetësonin gruan dhe bënin sikur po nxirrnin mushkonjat. Gruaja i shikonte me bisht të syrit hajdutët dhe thërriste: Hasan, Hysejn, më ndihmoni nga këto mushkonja. Hajdutën menduan se po të vazhdonte kështu, gruaja do të lajmëronte të gjithë botën. Kështu që filluan ta kruanin me një shkop që kishin në dorë me qëllim që të qetësohej. Gruaja filloi të gudulisej dhe filloi të qeshte me të madhe. Fundja, nëse nuk qeshte tani, kur të qeshte? Djemtë u zgjuan nga të qeshurat e nënës së tyre. Sapo djemtë hapën derën, gruaja e moshuar bërtiti: Hasan! Hysejn! Kapini hajdutët! Djemtë u hodhën mbi hajdutët dhe i goditën sa mundën. Pastaj u lidhën duart dhe sytë dhe i lanë në rrugë të fshatit, kështu nuk do të mund të mërznitnin të tjerët dhe të tjerët të merrnin mësim.






Zemra jonë gjatë ditës rreh njëqind e një mijë herë. Zemra pa pushim dhe plot mundime gjatë jetës afërsisht rreh tre miliard herë. Dhe afërsisht pompon katërqind milion litra gjak.

Kështu që është mirë që të kujdesemi mirë për të dhe t'i shërbejmë asaj. Për shembull, të mos ngrihemi menjëherë nga shtrati. Ta bëjmë këtë në mënyrë të qetë.

- A e keni matur gjatësinë e kyçit të dorës deri tek bërryli dhe kyçin e këmbës deri tek gjuri? Mund ta provoni. Dhe nëse e provoni do të shikoni që gjatësia e tyre është e njëjtë. E habitshe apo jo?

- Çfarë fruti i shijshëm! Po më shkon goja lëng! A keni menduar deri më tani rreth lëngut të gojës ose thënë ndryshe pështymës? A e dini se





hormonet që krijojnë pështyma në gojë janë si një burim që valon? A e dini se sa pështymë krijojnë gjuha jonë gjatë ditës? Është e habitshme! Gjuha jonë gjatë ditës krijojnë një litër pështymë.

- Meqë ra fjala, sa mund ta mbani frymën tuaj? Zakonisht, të gjithë njerëzit mund ta mbajnë frymën një minutë. Rekord i shënuar për mbajtjen e frymës dhe që është mjaft i gjatë është shtatë minuta e gjysmë.
- Kur ndiejmë etje? A mund ta përcaktojmë? Pyetje e çuditshme apo jo? Sa herë që trupi ynë humb një përqind të energjisë ndiejmë etje. Çdo njeri, afërsisht shpenzon 75000 litra ujë.
- A e dini se sa kg ke lindur? A e dini se foshnja kur lind, një e katërta e peshës së tij është koka! Është e vërtetë. Rreth një e katërta e peshës kur lindim na peshon vetëm koka.

